

Analiza e përgjigjeve të Pyetësorit për Komisionet komunale për marrëdhënie ndëretnike

(Përgatitur nga Aisling Lyon, prill 2011)

Konteksti:

Qëllimi i këtij pyetësori të shkurtër ishte të mbledhë informata për atë se si anëtarët e Komisioneve komunale për marrëdhënie ndëretnike e kuptojnë punën e tyre për t'i promovuar marrëdhëniet ndëretnike në nivel lokal. Anëtarët e komisioneve u përgjigjën gjithsej në nëntë pyetje, të cilat përfshinë një sërë çështjesh, siç janë marrëdhëniet e Komisioneve me Këshillin komunal, si komunikojnë ata me komunitetet e ndryshme që i përfaqësojnë, dhe perceptimi i tyre për efektivitetin e punës së tyre brenda komunitetit më të gjerë. Lista me pyetjet e parashtuara, së bashku me një analizë të shkurtër të përgjigjeve, është bashkangjitur më poshtë.

Pyetësori u është dhënë anëtarëve të Komisioneve të cilët morën pjesë në konferencën që u organizua në kuadër të projektit 'Model për komunikim efikas ndërmjet Komisioneve për marrëdhënie ndëretnike dhe qytetarëve' (MEK), që u mbajt në hotelin Holiday Inn në Shkup, ditën e mërkurë, më 9 mars 2011. Projekti MEK u financua nga Bashkimi Evropian dhe u implementua nga Fondacioni Metamorfozis, në partneritet me Asociacionin qytetar për përkrahje të dialogut ndëretnik dhe zhvillimit të bashkësisë, 'Vlera të përbashkëta'.

Për ata që e plotësuan pyetësorin:

Gjithsej, 26 anëtarë të Komisioneve për marrëdhënie ndëretnike, që përfaqësonin 11 komuna të ndryshme, u përgjigjën në këtë pyetësor. Detaje të tjera për plotësuesit e pyetësorit janë dhënë në tabelën e mëposhtme dhe në fund të analizës (pyetja 10).


Është me rëndësi të theksohet se ata që e plotësuan këtë pyetësor, nuk përbëjnë model reprezentativ të të gjithë anëtarëve të Komisioneve të qyteteve në Maqedoni. Analiza e përfshirë në pjesët e mëposhtme nuk mund të përgjithësohet dhe duhet të konsiderohet vetëm një përshtypje e përafërt për atë se si disa anëtarë të Komisioneve e kuptojnë punën që e bëjnë.

Ata që e plotësuan pyetësorin, paraqesin përzierje të anëtarëve të Komisioneve që morën pjesë në projektin MEK dhe të atyre që nuk morën pjesë në të. Prandaj, përgjigjet në pyetjet janë ndarë në mënyrë adekuate.

Emri i komunës	Numri i atyre që e plotësuan pyetësorin	Kanë marrë pjesë në projekt?
Çair	5	Po
Dibër	5	Po
Gostivar	3	Po
Tetovë	3	Po
Brvenicë	3	Jo
Çaçkë	1	Jo
Qyteti i Shkupit	1	Jo
Çuçer Sandevë	1	Jo
Kërçovë	2	Jo
Studenicë	1	Jo
Vrapçisht	1	No


1.) Cilat detyra i realizon Komisioni për marrëdhënie ndëretnike në komunën tuaj?

- a) Mundëson dialog institucional ndërmjet bashkësive të ndryshme etnike;
- b) U mundëson qytetarëve të marrin pjesë në punën e komunës edhe me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur;
- c) Propozon zgjidhje deri te Këshilli i komunës për çështje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndëretnike;
- d) Bashkësive ua sqaron prapavijën dhe relevancën e vendimeve dhe politikave komunale.




Pjesa më e madhe e komisioneve që e plotësuan pyetësin, i kryejnë detyrat të cilat kërkojnë prej tyre formalisht. Nga ana tjetër, një numër i vogël i Komisioneve ua sqarojnë qëllimin dhe rëndësinë e vendimeve dhe të politikave komunale, komuniteteve që i përfaqësojnë.

Përgjigjet në këtë pyetje nuk dallojnë ndërmjet Komisioneve komunale që morën pjesë në trajnim dhe atyre që nuk morën pjesë në të.





Përgjigjet nga Komisionet që morën pjesë në projektin MEK.



Përgjigjet nga Komisionet që nuk morën pjesë në projektin MEK.



2.) Sa shpesh, Këshilli komunal konsultohet me Komisionin gjatë marrjes së vendimeve që kanë të bëjnë me punën e tij?



3.) Sa shpesh, Këshilli i komunës i pranon rekomandimet e Komisionit gjatë marrjes së vendimeve që kanë të bëjnë me punën e tij?



Përgjigjet në pyetjet 2 dhe 3 sygjerojnë se ka më shumë gjasa që Këshillat komunalë t'i pranojnë rekomandimet e Komisionit se sa vetëm të konsultohen me ta. Megjithatë, përgjigjet ndryshojnë dukshëm në mes të komunave që morën pjesë në projektin MEK dhe atyre që nuk morën pjesë në të. Ka më pak gjasa që Komisionet që nuk morën pjesë në trajnimin e projektit MEK, të kenë raporte të tilla pozitive të punës me Komisionin e tyre komunal për marrëdhënie ndëretnike.

P2: Shpeshtësia me të cilën Këshillat komunalë konsultohen me Komisionet:



Komisionet që morën pjesë në projektin MEK. Komisionet që nuk morën pjesë në projektin MEK.


P3: Shpeshtësia me të cilën Këshillat komunalë i pranojnë rekomandimet e Komisioneve:



Komisionet që morën pjesë në projektin MEK. Komisionet që nuk morën pjesë në projektin MEK.


4.) Kur Këshilli i komunës punon me Komisionin, për cilat çështje konsultohet me të dhe i pranon rekomandimet e tij?

- a) Çështje nga kultura dhe organizimi i ngjarjeve kulturore;
- b) Përdorimi i gjuhëve në komunë;
- c) Emërtimi i rrugëve dhe i infrastrukturës tjetër, si p.sh. shkolla, ndërtesa kulturore;
- d) Përdorimi i simboleve kulturore, si p.sh. flamujt;
- e) Konteste dhe konflikte në bashkësi.




Këshillat komunalë, sipas të gjitha gjasave konsultohen me Komisionet dhe i pranojnë rekomandimet e tyre për një numër të madh çështjesh që janë relevante për bashkësitë lokale etnike. Nuk ka ndonjë çështje të veçantë për të cilën Këshillat komunalë do të punonin më me efektivitet me Komisionet për marrëdhënie ndëretnike.

Përgjigjet në këtë pyetje nuk ndryshojnë shumë në mes të komunave që morën pjesë në projektin MEK dhe atyre që nuk morën pjesë në të.




Përgjigjet nga Komisionet që morën pjesë në projektin MEK.



Përgjigjet nga Komisionet që nuk morën pjesë në projektin MEK.

Komisioni gjatë 12 muajve të fundit?

5.) Sa shpesh është takuar




Shumica e pjesëmarrësve që e plotësuan pyetësoin theksuan se Komisioni të cilit i takojnë, mban takime të rregullta (1-3 herë në vit). Nja 20 përqind të tjerë thanë se Komisioni i tyre është takuar më shumë se 3 herë gjatë vitit të kaluar. Kjo paraqet një shenjë shumë inkurajuese.


Megjithatë, kur të dhënat ndahen në mes të Komisioneve që morën pjesë në projektin MEK dhe atyre që nuk morën pjesë në projekt, të dhënat janë më pak konzistente.

Përgjigjet sygjerojnë se Komisionet që nuk morën pjesë në projektin MEK takohen shumë më rrallë; në fakt, thuhet gjysma e atyre që e plotësuan pyetësoin theksuan se Komisioni të cilit i takojnë, është takuar vetëm një herë gjatë vitit të kaluar.

Megjithatë, është inkurajues fakti se të gjitha Komisionet që e plotësuan pyetësoin janë takuar së paku një herë gjatë vitit të kaluar.




Përgjigjet nga Komisionet që morën pjesë në projektin MEK.



Përgjigjet nga Komisionet që nuk morën pjesë në projektin MEK.


6.) Si Komisioni i identifikon dhe i zgjedh çështjet relevante?

- I analizon rendet e ditës të Këshillit të Komunës;
- Me iniciativë të këshilltarëve komunalë ose të administratës komunale;
- Me iniciativë të anëtarëve të Komisionit;
- Duke i shqyrtuar propozimet ose iniciativat e parashtruara nga qytetarë individualë ose grupe të qytetarëve nga bashkësia.




Komisionet që e plotësuan pyetësorin, theksuan se sipas të gjitha gjasave ata do t'i identifikojnë dhe do t'i zgjedhin për diskutim çështjet që janë propozuar nga organizatat qytetare lokale dhe vetë anëtarët e Komisioneve. Ka shumë më pak gjasa që Komisionet të punojnë me Këshillat përkatës komunalë, në identifikimin e çështjeve relevante për shqyrtim.

Megjithatë, përgjigjet ndryshojnë dukshëm në mes të atyre që morën pjesë në projektin MEK dhe atyre që nuk morën pjesë në projekt. Për shembull, ka shumë më pak gjasa që Komisionet që morën pjesë në projektin MEK ta analizojnë agjendën e Këshillit komunal në procesin e identifikimit të çështjeve relevante, se sa Komisionet që nuk morën pjesë në projekt.




Përgjigjet nga Komisionet që morën pjesë në projektin MEK.



Përgjigjet nga Komisionet që nuk morën pjesë në projektin MEK.


7.) Në çfarë mënyre Komisioni i njofton qytetarët për vendimet e tij?

- a) Në mbledhjet e Këshillit të komunës;
- b) Në këndin e shpalljeve në komunë;
- c) Nëpërmjet medimeve lokale;
- d) Nëpërmjet grupeve lokale të qytetarëve ose organizatave joqeveritare.




Komisionet bënë me dije se ka më shumë gjasa që qytetarëve t'ua komunikojnë vendimet e tyre nëpërmjet medimeve lokale, grupeve lokale të qytetarëve ose organizatave joqeveritare, e poashtu edhe gjatë mbledhjeve të Këshillit komunal. Ka më pak gjasa që ato t'i shfrytëzojnë hapësirat komunale për shpërndarjen e informatave për punën e tyre. Duke pasur parasysh frekuencën e vogël të përgjigjeve pozitive, për secilën prej katër mundësive për shpërndarjen e informatave (karahasuar me përgjigjet në pyetjet e mëparshme), është diskutabile se sa prioritet të lartë paraqet për Komisionin, puna në terren/komunikimi i rregullt me qytetarët lokalë.

Përgjigjet ndryshojnë dukshëm në mes të atyre që morën pjesë në projektin MEK dhe atyre që nuk morën pjesë në projekt. Komisionet që morën pjesë në projektin MEK ka më shumë gjasa që t'i shfrytëzojnë mediumet lokale si mekanizëm për komunikim me qytetarët lokalë. Për dallim, Komisionet që nuk morën pjesë në trajnimin e projektit MEK, ka më shumë gjasa të mbështeten në diskutimet që zhvillohen në kuadër të mbledhjeve, për t'i bërë publike vendimet e tyre.




Përgjigjet nga Komisionet që morën pjesë në projektin MEK.



Përgjigjet nga Komisionet që nuk morën pjesë në projektin MEK.

8.) Çfarë përkrahje ofron komuna për Komisionin?


- a) Hapësirë për punë (hapësirë për takime të Komisionit);
- b) Materiale për punë (qasje në dokumentet komunale);
- c) Përkrahje administrative (një anëtar i administratës komunale organizon takime dhe të ngjashme);
- d) Publicitet (publikon lajmërimi publike për rolin e Komisionit dhe datat e takimeve të ardhme);
- e) Siguron buxhet për punën e Komisionit (mbulim të harxhimeve të anëtarëve).



Përgjigjet në këtë pyetje sugjerojnë se në shumicën e rasteve, komunat ofrojnë një sërë të mekanizmave që përkrahin punën e Komisioneve. Ka shumë më tepër gjasa që komunat të ofrojnë hapësirë pune, ku Komisionet do të mund t'i mbajnë mbledhjet e tyre, se sa ta ofrojnë përkrahjen e nevojshme administrative, si për shembull qasje në dokumentet komunale dhe në buxhetin për t'i mbuluar harxhimet për punën e Komisionit (duke i përfshirë edhe harxhimet për anëtarët).

Përgjigjet ndryshojnë në mes të atyre që morën pjesë në projektin MEK dhe atyre që nuk morën pjesë në projekt, megjithatë, jo në masë të madhe. Të gjithë anëtarët e Komisioneve që morën pjesë në projektin MEK dhe që e plotësuan pyetësorin, bënë me dije se komuna u ka ofruar hapësirë pune për takimet e tyre (për dallim nga 80 përqind e atyre që e kanë plotësuar pyetësorin dhe të cilët nuk kanë marrë pjesë në trajnim).


Këto Komisione kanë më shumë gjasa që t'u ofrohet buxhet nga komuna për t'i mbuluar harxhimet e tyre (por vetëm te, përafërsisht, 70 përqind të përgjigjeve).



Përgjigjet nga Komisionet që morën pjesë në projektin MEK.


Përgjigjet nga Komisionet që nuk morën pjesë në projektin MEK.

9.) Sipas mendimit Tuaj, sa është efektiv Komisioni në përmbushjen e rolit të tij në komunën Tuaj?




Pjesa më e madhe e anëtarëve të Komisioneve që e plotësuan pyetësin konsiderojnë se Komisioni i tyre ishte ‘mjaft efektiv’ në përmbushjen e detyrave të tij. Këtë mendim e kanë përafërsisht dy të tretat e atyre që e plotësuan pyetësin.

Megjithatë, vlerësimet sa i përket efektivitetit të Komisioneve, dallojnë në mes të Komisioneve që morën pjesë në projektin MEK dhe atyre që nuk morën pjesë në projekt. Shumë më pak anëtarë të Komisioneve që morën pjesë në trajnimin e projektit MEK konsiderojnë se puna e tyre ‘nuk ishte aspak efektive’ (më pak se 10 përqind për dallim nga 30 përqind). Është interesant fakti se përqindja e atyre që e plotësuan pyetësin dhe që konsiderojnë se Komisioni të cilit i takojnë ka qenë ‘shumë efektiv’, është pothuajse identik, pa marrë parasysh se a kanë marrë pjesë në projektin MEK ose jo.



Përgjigjet nga Komisionet që morën pjesë në projektin MEK.



Përgjigjet nga Komisionet që nuk morën pjesë në projektin MEK.

10.) Për ata që e plotësuan

pyetësorin:

a.) Emri i komunës:

Emri i komunës	Numri i atyre që e plotësuan pyetësorin	Kanë marrë pjesë në projekt?
Çair	5	Po
Dibër	5	Po
Gostivar	3	Po
Tetovë	3	Po
Bërvenicë	3	Jo
Çashkë	1	Jo
Qyteti i Shkupit	1	Jo
Çuçer Sandevë	1	Jo
Kërçovë	2	Jo
Studenica	1	Jo
Vrapçisht	1	No

b.) Përkatësia etnike e atyre që e plotësuan pyetësorin:

Përkatësia etnike	Numri i atyre që e plotësuan pyetësorin
Shqiptar	12
Bosnjak	2
Maqedonas	7
Rom	0
Serb	2
Turk	1
Vllah	0
Tjetër	2
E panjohur	1

